

**VENDIM**  
**Nr.1696, datë 24.12.2008**

**PËR KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT FIZIK, NGA OBJEKTE**  
**SHTETËRORE TË “ALBMINIERA” SHA DHE SHËRBIMIT GJEOLGJIK**  
**SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në fondin e kompensimit fizik dhe vënien në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të 32 objekteve shtetërore të “Albminiera” sha-së dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi të bëjë verifikimin përfundimtar të pronësive së trullit për objektet, përbërëse të fondit të mësipërm, ta përdorë fondin për kompensimin e pronarëve, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.

3. Pas verifikimit përfundimtar, të bërë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronat, të cilat rezultojnë me njohje apo kthim pronësie, të hiqen nga fondi i kompensimit fizik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**OBJEKTET E SHOQËRISË “ALBMINIERA” SHA DHE TË SHËRBIMIT GJEOLGJIK**  
**SHQIPTAR, QË DO TË PËRFSHIHEN NË FONDIN E KOMPENSIMIT FIZIK**

| Nr. | Emërtimi                                           | Institucioni                 | Nd/ja nga varet                                  | Vendndodhja |
|-----|----------------------------------------------------|------------------------------|--------------------------------------------------|-------------|
| 1   | Ndërtesa 1-katëshe e magazinës së gjeofizikës      | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë     |
| 2   | Ndërtesë 2-katëshe magazinë+ kapanone auto         | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë     |
| 3   | Zyrat e katit të parë                              | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë     |
| 4   | Ndërtesa e depos së qymyrit dhe zdruktarisë        | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë     |
| 5   | Magazinë nr.2 e ofiçinës                           | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë     |
| 6   | Ofiçina                                            | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë     |
| 7   | Ndërtesë 1-katëshe e magazinës nr.1                | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë     |
| 8   | Ndërtesë 1-katëshee magazinës me vinç ure (shtesë) | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik         | Bulqizë     |

|    |                                                         |                              |                                                  |                             |
|----|---------------------------------------------------------|------------------------------|--------------------------------------------------|-----------------------------|
|    |                                                         |                              | Bulqizë                                          |                             |
| 9  | Ndërtesë 1-katëshe e magazinës me vinç urë              | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë                     |
| 10 | Ndërtesë 1 katëshe e magazinës së tubave                | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Bulqizë                     |
| 11 | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar                            | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel  | Burrel                      |
| 12 | Ofiçina e ndërmarrjes                                   | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel  | Burrel                      |
| 13 | Zyra kati parë të ndërmarrjes                           | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel  | Burrel                      |
| 14 | Magazinë 1 katëshe e ndërmarrjes                        | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel  | Burrel                      |
| 15 | Magazinë 1katëshe e ish-ekspeditës gjeologjike Peshkopi | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë | Peshkopi                    |
| 16 | Kapanoni i automjeteve nr.1                             | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik   | Rubik                       |
| 17 | Kapanoni i automjeteve nr.2                             | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik   | Rubik                       |
| 18 | Kapanoni i autoofiçinës                                 | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik   | Rubik                       |
| 19 | Vendrojtë                                               | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik   | Rubik                       |
| 20 | Ndërtesë dykatëshe e laboratorit                        | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik   | Rubik                       |
| 21 | Ndërtesë dykatëshe e zyrave (kati i parë)               | Shërbimi gjeologjik shqiptar | Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik   | Rubik                       |
| 22 | Menca e sektorit pusi nr.1                              | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera 1 xhabokike sek.III |
| 23 | Magazina e fabrikës                                     | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera 1 xhabokike sek.III |
| 24 | Llambisteri pusi nr.1                                   | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera 1 xhabokike sek.III |
| 25 | Menca e punëtorëve pusi nr.2                            | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera nr.2 Dervishaj      |
| 26 | Dush e gardërobë pusi nr.1                              | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera 1 xhabokike sek.III |
| 27 | Dush e gardërobë pusi nr.2                              | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera nr.2 Dervishaj      |
| 28 | Llambisteri pusi nr.2                                   | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera nr.2 Dervishaj      |
| 29 | Salla e kompresorëve nr.2                               | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera nr.2 Dervishaj      |
| 30 | Zyrat e fabrikës pusi nr.1                              | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera 1 xhabokike sek.III |
| 31 | Zyrat e sektorit pusi nr.2                              | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera nr.2 Dervishaj      |
| 32 | Zyra + magazinë                                         | Albminiera sh.a.             | Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj                 | Miniera 1 xhabokike sek.III |